

OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
DEPARTAMENTI I RRJETIT TË TRANSMETIMIT
DREJTORIA E PLANIFIKIM ZHVILLIMIT TË RRJETIT TË TRANSMETIMIT

Nr. 3465/prot.
1

Tiranë, më 09.06.2021

Lënda: Kthim përgjigje lidhur me kërkesën për derogim nga shoqëria Kalisi Hydropower sh.p.k. për mënyrën e lidhjes së HEC Veleshica 2 me linjën 110 kV Peshkopi-Lapaj

ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË ✓

Blv. Bajram Curri, Rr. Viktor Eftimiu, nr. 1023, Tiranë

Në përgjigje të shkresës Nr. 667/2 Prot., më datë 28.05.2021, me anë të së cilës kërkoni opinion në lidhje me derogimin e kërkuar nga shoqëria Kalisi Hydropower sh.p.k. për mënyrën e lidhjes së HEC Veleshica 2 me rrjetin e transmetimit në linjën 110 kV Peshkopi-Lapaj, Ju bëjmë me dije si më poshtë:

OST sh.a. siguron lidhjen e përdoruesve të sistemit me rrjetin e transmetimit, në bazë të ligjit Nr. 43/2015, "PËR SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE" dhe akteve nënligjore në fuqi që rregullojnë procesin e lidhjes në rrjet.

Shoqëria Kalisi Hydropower sh.p.k. ka nënshkruar Marrëveshjen e Lidhjes me OST sh.a., me Nr. 531 Prot., datë 18.01.2019, për lidhjen në rrjetin e transmetimit të HEC-eve Veleshica 1 dhe 2, dhe ka amenduar këtë marrëveshje me Nr. 1957 Prot., datë 18.03.2021, për fuqinë transformatorike të instaluar në Nënstacion 110/20/6.3 kV pranë HEC Veleshica 1.

Bazuar në "Kodin e rrjetit mbi kërkesat për lidhjen me rrjetin të gjeneruesve" të miratuar me vendimin e bordit të ERE me Nr. 129, datë 04.06.2018, specifikisht Nenit 61 të këtij kodi dhe "Kodit të Rrjetit të Transmetimit" të miratuar me vendimin e bordit të ERE me Nr. 186, datë 10.11.2017, specifikisht Nenit 12 të këtij kodi shprehemi si më poshtë:

Shoqëria kërkon derogim mbi infrastrukturën e lidhjes, për të zhvilluar traktet 110 kV të linjës në N/Stacionin 110/20/6.3 kV pranë HEC Veleshica 1 në dy faza (në fazën e parë traktet të jenë të pajisur me elementët: shkarkues, transformator tensioni dhe thikë fuqie me dy thika toke dhe në fazën e dytë, pas 24 muaj nga aprovimi i derogimit, plotësimin e trakteve 110 kV të linjave me të gjithë elementët e nevojshëm primar dhe sekondar sipas kushteve të Marrëveshjes së Lidhjes/ të amenduar).

Në kushtet aktuale, shoqëria duhet të marrë në konsideratë që OST sh.a. është në proces fuqizimi të rrjetit të transmetimit në këtë rajon nëpërmjet investimeve të cilat janë në proces realizimi apo parashikohen në planin e zhvillimit. Në këtë periudhë kohore, 24 muaj të derogimit, garantimi i sigurisë së furnizimit mund të ndikohet nga veprimet operacionale.

Për shkak të fazës në procesin e lidhjes që paraqitet ky derogim, mbështetur në procedurë përkatëse, shoqëria do të duhet të miratojë të dy projektet e zbatimit (për fazën e parë sipas skemës së propozuar për derogim dhe në fazën finale sipas skemës pas derogimit 24 mujor) pranë OST sh.a.

Ju faleminderit për mirëkuptimin,

ADMINISTRATOR i OST sh.a.

